




Oda e Mjekëve të Kosovës
Lekarska Komora Kosova
Kosovo Doctors Chamber

		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia:	<u>ZK</u>	Nr. Prot.:	<u>223119</u>
Unit:		Prot. No.:	
Jednica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:	<u>2</u>	Data:	<u>16.05.2019</u>
No. of pages:		Datum:	
Br. stranice:		Prathtësia:	



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova
Dental Chamber of Kosovo

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MIDIS ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS DHE ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS

Neni 1

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe Oda e Stomatologëve të Kosovës (në vazhdim *Palët*) "shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunimin e qëndrueshëm sipas fushave përkatëse, duke e konsideruar të domosdoshëm këtë bashkëpunim për rritjen dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së kujdesit Shëndetësor.

Neni 2

Palët dakordohen për ngritjen e grupeve të përbashkëta të kontrollit për zbatimin e standardeve ligjore dhe etiko-morale nga ana e mjekëve dhe stomatologëve në institucionet publike dhe private.

Neni 3

Palët dakordohen për shkëmbim të informacioneve reciproke në funksion të përmirësimit të cilësisë së ushtrimit të profesionit të mjekut dhe stomatologut në institucionet shëndetësore publike dhe private.

Neni 4

Palët dakordohen për t'i njohur disa nga format e ndryshme të organizimit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në mënyrë reciproke me anë të akreditimit.

Neni 5

Oda e Mjekëve të Kosovës do ta mbështesë Odën e Stomatologëve të Kosovës në përgatitjen e rregulloreve, dokumenteve si dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e përbashkët.

Neni 6

Palët bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidentuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjelltë midis dy institucioneve.

Neni 7

Ky memorandum lidhet për një afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

Neni 9

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 16.05. 2019

Për Odën e Mjekëve të Kosovës

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sc



Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Prof.Dr. Blerim Kamberi

